

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe
Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar
Advanced Financial Reporting

P9

Zgjidhjet

Data
26/09/2020

1. Pasqyrat e pozitës financiare me poshtë janë të datës 31 dhjetor 2019:

	Nile sh.a €m	Amazon sh.a €m	Yangtze sh.a €m
Pasuritë			
Pasuritë jo-qarkulluese të trupëzuara	1,280	440	280
Investimet në Amazon sh.a	400	-	-
Investimet në Yangtze sh.a	60	-	-
Pasuritë qarkulluese	<u>544</u>	<u>190</u>	<u>130</u>
Total pasuritë	2,284	630	410
Ekuiteti dhe detyrimet			
Aksionet e zakonshme	950	260	230
Rezerva e rivlerësimit	90	-	-
Fitimet e mbajtura	<u>390</u>	<u>210</u>	<u>94</u>
Total ekuiteti	1,430	470	324
Detyrimet afatgjata	640	30	16
Detyrimet afatshkurtëra	<u>214</u>	<u>130</u>	<u>70</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	2,284	630	410

Nile sh.a bleu pronësinë si në vijim në Amazon sh.a dhe Yangtze sh.a.

	Data e blerjes	Pronesia e blerë	Vlera e drejtë e neto pasurive €m	Konsiderata e blerjes €m
Amazon sh.a	1 janar 2017	10%	325	30
Amazon sh.a	1 janar 2019	70%	460	370
Yangtze sh.a	1 janar 2019	25%	200	60

Ju janë dhënë informatat në vijim të cilat do të jenë të rëndësishme për pasqyrat e konsoliduara financiare të Nile sh.a.

- i) Me 1 janar 2017, vlera bartëse e neto pasurive të Amazon sh.a ishte e njëjtë me vlerën e drejtë të tyre prej €325 milion.
- ii) Vlera e drejtë e vlerësuar e investimit fillestar prej 10% në aksionet e Amazon sh.a ishte €40 milion me 31 dhjetor 2018.
- iii) Nile sh.a dëshiron të përdor metoden e vlerës së drejtë të plotë të kontabilizimit të blerjes së Amazon sh.a. Me 1 janar 2019 vlera e drejtë e vlerësuar e interesave jo-kontrollues ishte €95 milion.
- iv) Diferenca ndërmjet vlerës bartëse dhe vlerës së drejtë të pasurive neto të Amazon sh.a-së në datën e blerjes ishte për shkak të tokës e cila ishte paraqitur sipas kostos dhe me 1 janar 2019 kishte vlerë të drejtë prej €25 milion mbi vlerën e saj bartëse. Nuk ka pasur ndryshim në këtë vlerë më pas.
- v) Me 1 janar 2019 vlera e drejtë e tokës së Yangtze sh.a-së ishte €16 milion mbi vlerën e saj bartëse. Nuk ka pasur ndryshim në këtë vlerë më pas.

- vi) Zëri i mirë në blerje testohet për dëmtim në secilin fundvit. Shuma e rikuperueshme e zërit të mirë në Amazon sh.a me 31 dhjetor 2019 ishte €30 milion.
- vii) Nuk ka pasur dëmtim në investimin në Yangtze sh.a.
- viii) Gjatë vitit, drejtorët e Nile sh.a vendosën të formojnë një skemë të pensioneve me përfitime të paracaktuara për punonjësit e saj. Kompania kontribuoi me para prej €250 milion në këtë skemë por e vetmja hyrje në kontabilitet për këtë ishte përfshirja në të arkëtueshmet me 31 dhjetor 2019.

Me 31 dhjetor 2019 detajet e mëposhtme kanë të bëjnë me skemën e pensioneve:

	€m
Vlera e tanishme e obligimeve	317
Vlera e drejtë e pasurive të planit	302

Kërkohet:

Përgatite pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të grupit Nile sh.a me 31 dhjetor 2019. (20 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor 2019

	€m
Pasuritë	
Pasuritë jo-qarkulluese të trupëzuara (L14)	1,745
Pasuritë jo-qarkulluese të patrupëzuara (L13)	30
Investimi në ortakëri (L15)	95
Pasuritë qarkulluese (544 + 190 - 250)	<u>484</u>
	2,354
Ekuiteti dhe detyrimet	
Aksionet e zakonshme	950
Rezerva e rivlerësimit	90
Fitimet e mbajtura (L17)	<u>186</u>
	1,226
Intereat jo-kontrollues (L18)	<u>99</u>
	1,325
Detyrimet afatgjata (640 + 30)	670
Detyrimet afatshkurtëra (214 + 130)	344
Detyrimi ndaj planit të pensioneve (L16)	<u>15</u>
	2,354

Llogaritjet

(L11) Permbledhjet e neto pasurive

Amazon sh.a

	Në datën e raportimit 31 dhjetor 2019	Në datën e blerjes 1 janar 2019	Pas blerjes
	€m	€m	€m
Aksionet e zakonshme	260	260	-
Fitimet e mbajtura	210	175	35
Korigjimet e VD	<u>25</u>	<u>25</u>	-
VD (e dhënë)	495	460	35

Yangtze sh.a

	Në datën e raportimit 31 dhjetor 2019	Në datën e blerjes 1 janar 2019	Pas blerjes
	€m	€m	€m
Aksionet e zakonshme	230	230	-
Fitimet e mbajtura	94	(46)	140
Korigjimet e VD	<u>16</u>	<u>16</u>	-
VD	340	200	140

(L12) Përfitimi ose humbja në marrjen e kontrollit të Amazon sh.a

	€m
1 janar 2019	
Vlera e drejtë e investimit fillestar në Amazon sh.a me 1 janar 2019	40
Kosto fillestare e investimit	<u>30</u>
Përfitimi i njohur në marrjen e kontrollit të Amazon sh.a	10

Ky përfitim nuk është njohur ende në pasqyrat financiare individuale të Nile sh.a; andaj duhet të përfshihet në llogaritjet e rezervave të grupit (shih llogaritjet 8).

(L13) Zëri i mirë në blerjen e Amazon sh.a

	€m
Konsiderata e transferuar për të marrë kontrollin	370
Vlera e drejtë e investimit fillestar në blerje	40
Interesat jo-kontrollues në blerje (sipas vlerës së drejtë)	<u>95</u>
	505
E drejtë e neto pasurive të blera	<u>460</u>
Total zëri i mirë në datën e blerjes	45
Dëmtimi (shifër balancuese)	<u>(15)</u>
Zëri i mirë në datën e raportimit	30

Dëmtimi i zërit të mirë prej €15 milion ndahet ndërmjet pronarëve të Nile sh.a edhe IJK-së në raport 80:20.

Dëmtimi i zërit të mirë atribuar prindit = €15m x 80% = €12m

Dëmtimi i zërit të mirë atribuar IJK-së = €15m x 20% = €3m.

(L14) Pasuritë jo-qarkulluese të trupëzuara

	€m
Nile sh.a	1,280
Amazon sh.a	440
Korrigjimet e VD	<u>25</u>
	1,745

(L15) Investimet në ortakëri - Yangtze sh.a

	€m
Kosto	60
Pjesa e grupit e fitimeve pas blerjes $(94 - (46)) \times 25\%$	<u>35</u>
	95
Në mënyrë tjetër	
€m	
Pjesa e grupit e vlerës së drejtë të ortakërisë në datën e raportimit $(25\% \times 340)$	85
Zëri i mirë në ortakëri $(60 - 50)$	<u>10</u>
	95

(L16) Pensionet

Shuma e paguar për të krijuar skemën duhet të largohet nga të arkëtueshmet, dhe detyrimet neto ndaj pensioneve duhet të njihen në pasqyrën e pozitës financiare. Hyrja e dyfishtë për të arritur këtë është si në vijim:

	D	K
	€m	€m
Fitimet e mbajtura (shifër balancuese)	265	
Të arkëtueshmet		250
Detyrimet ndaj skemës së pensioneve $(317 - 302)$		15

Shënim për mësim: Shuma e njohur në fitimet e mbajtura përbëhet nga kthimi në pasuritë e planit, interesat, koston aktuale të shërbimit dhe përfitimet apo humbjet nga vlerësimet e ekspertëve. Nëse do të kërkohej përgatitja e pasqyrës së konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, këto shuma do të duhej të identifikoheshin ndarazi dhe në këtë detyrë ashtu kështu informatat e nevojshme për këtë nuk janë dhënë në pyetje.

(L17) Fitimet e mbajtura të konsoliduara

	€m
Nile sh.a (sipas pyetjes)	390
Pjesa e fitimeve të mbajtura pas blerjes të Amazon sh.a (210 - 175 (L11)) × 80%	28
Përfitimi në marrjen e kontrollit (L12)	10
Dëmtimi i zërit të mirë atribuar prindit (L13)	(12)
Pjesa e fitimeve pas blerjes së ortakërisë (L15)	35
Korigjimet e pensioneve (L16)	<u>(265)</u>
	186

(L18) Interesat jo-kontrollues në Amazon sh.a

	€m
VD në datën e blerjes	95
Pjesa e fitimeve të mbajtura pas blerjes (210 - 175 (L11)) × 20%	7
Dëmtimi i zërit të mirë atribuar IJK-së (L13)	<u>(3)</u>
	99

Në mënyrë tjetër

	€m
Vlera në libra (20% × 470)	94
Korigjimet e VD (20% × 25)	5
Zëri i mirë (3 - dëmtimi 3) (L13) [95 - (20% × 460) - 3]	<u>0</u>
	99

2.

(a) Madeira sh.a siguroi një kontratë për të ndërtuar një rrugë prej 20 km në Prishtinë. Kontrata ka një çmim prej €1,000,000. Punët do të duhej të fillojnë me 1 nëntor 2020 dhe pritet të përfundojnë me 31 tetor 2023. Madeira sh.a nuk ka as makineri e as para për të ndërtuar rrugën. Kompania mundet vetëm të siguroj burimet njerëzore dhe mbështetje teknike. Madeira sh.a ka kontaktuar Purus sh.a për tu bërë partner me të. Purus sh.a do të siguroj të gjitha makineritë e nevojshme. Të dy kompanitë kanë hyrë në një aranzhim me kushtet në vijim:

- (i) Madeira sh.a do të jetë përgjegjëse për pagesat, sigurimin shëndetësor dhe sigurinë në punë të të gjithë punonjësve me të cilët ajo do të kontribuoj;
- (ii) Purus sh.a do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe sigurimin e makinerive;
- (iii) Të dy kompanitë, Madeira sh.a dhe Purus sh.a do të ndajnë vlerën e kontratës 40% dhe 60% respektivisht.

Kërkohet:

Këshillo drejtorët e Madeira sh.a se si aranzhimi në të cilin kompania e tyre ka hyrë me Purus sh.a do të trajtohet në pasqyrat e tyre të konsoliduara të pozitës financiare përgjatë periudhës së kontratës. (7 pikë)

b) Drini sh.a është një kompani e cila raporton sipas SNRF-ve. Drini sh.a zakonisht operon vetëm brenda Kosovës ku edhe kanë lokacionin fizik zyret e saj. Së voni ka hyrë në një kontratë për të furnizuar me produktet e saj një klienti në Shqipëri. Obligimet ndaj kontratës janë përmbushur gjatë muajit nëntor 2019. Çmimi fiks i kontratës ishte 100 milion lekë shqiptar dhe do të paguhej në lek shqiptar. Shuma e plotë është faturuar me 1 dhjetor 2019 kur kursi i këmbimit ishte €1 = 10.1889 lekë. Klienti i kësaj kontrate pagoi në avans me 1 nëntor 2019 50 milion lekë kur kursi i këmbimit ishte €1 = 9.9783 lekë. Pjesa e mbetur do të paguhet në dy kiste të njejta prej 25 milion lekë secila me 31 mars 2020 and 30 qershor 2020. Kursi i këmbimit valutor me 31 dhjetor 2019 ishte €1 = 10.5037 lekë.

Drini sh.a vendosi të eliminoj diferencat e kursit të këmbimit valutor për dy pagesat e fundit dhe hyri në dy kontrata përpara (forward) me 1 dhjetor 2019 për të shitur shumën e duhur të lekëve me 31 mars 2020 dhe 30 qershor 2020, dhe i plotësuan kushtet për tu trajtuar si mbrojtje të vlerës së drejtë të llogarive të arkëtueshme. Me 31 dhjetor 2019, këto dy kontrata së bashku ishin vlerësuar si pasuri prej €148,000.

Kërkohet:

Trego dhe diskuto trajtimin në kontabilitet të zërave mësipër, duke përfshirë llogaritjet përkatëse, për aq sa lejojnë informatat e dhëna, në pasqyrat financiare të Drini sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019. (7 pikë)

c) Me 1 janar 2019, Parana sh.a emetoi 10,000 fletë-obligacione me shumë nominale prej €100 me një çmim të tregut prej €95. Brokëri i fletë-obligacioneve ngarkoi tarifa në total prej €18,000 lidhur me emetimin e 10,000 fletë-obligacioneve. Fletë-obligacioni bart një normë të kuponit

(interesi) vjetor prej 5% i pagueshëm në fund të çdo viti dhe shuma nominale e obligacionit është e ripagueshme pas 3 viteve në vlerë nominale.

Parana sh.a dëshiron ta kontabilizoj fletë-obligacionin sipas SNRF 9 *Instrumentet financiare* me metoden e kostos së amortizuar. Megjithatë, ka konfuzion se si fletë-obligacionet duhet të kontabilizohen. Aktualisht, paraja e pranuar nga emetimi i fletë-obligacioneve është €950,000 dhe është njohur si detyrim afatgjatë. Tarifat e brokerit prej €18,000 janë zbritur nga vlera bartëse e detyrimit afatgjatë, pagesa e kuponit prej €50,000 është njohur si shpenzim për llogaritjen e fitimit para tatimit dhe norma efektive e interesit është 7.62%.

Kërkohe:

Trego trajtimin në kontabilitet të transaksionit të mësipërm të Parana sh.a-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019. (6 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

2

- a) Gjatë përcaktimit të trajtimit në kontabilitet të Madeira sh.a duhet të vlerësoj nëse ka kontroll të përbashkët në aranzhim. SNRF 11 *Aranzhimet e përbashkëta* përkufizon kontrollin e përbashkët si marrëveshje kontraktuale të ndarjes së kontrollit të një aranzhimi, i cili ekziston vetëm kur vendimet për aktivitetet përkatëse kërkojnë pajtim unanim të palëve që ndajnë kontrollin. Aranzhimi kërkon që të dy kompanitë të kryejnë detyrat e tyre për të pasur sukses. Ka varësi që nënkupton ekzistencë të kontrollit të përbashkët.

Pas përcaktimit të ekzistencës së kontrollit të përbashkët, është me rëndësi të përcaktohet klasifikimi tij. Mund të jetë ose operacion i përbashkët ose sipërmarrje e përbashkët. Kjo është shumë më rëndësi për ta trajtuar drejtë në kontabilitet. Për të përcaktuar për klasifikimin e aranzhimit, Madeira sh.a duhet të vlerësoj kushtet e aranzhimit kontraktual së bashku me faktet tjera ose rrethanat për të vlerësuar nëse ka:

- Të drejtat në pasuritë dhe obligimet ndaj detyrimeve të aranzhimit. Kjo do të jetë indikator i një operacioni të përbashkët.
- Të drejtat në neto pasuritë e aranzhimit. Kjo do të jetë indikator i një sipërmarrje të përbashkët.

Madeira sh.a dhe Purus sh.a nuk kanë formuar një entitet të ndarë ligjrisht. Ata thjeshtë janë pajtuar të ekzekutojnë kontratën së bashku edhe pse kontrata ishte siguruar nga Madeira sh.a. Andaj, aranzhimi nuk ka obligim ndaj detyrimeve. Gjithashtu, kreditorët kanë kërkesa edhe nga Madeira sh.a dhe/ose Purus sh.a. Krejt në fund, aranzhimi kontraktual ndërmjet Madeira sh.a dhe Purus sh.a përcakton pjesën e secilës palë në çmimin e kontratës lidhur me aktivitetet e aranzhimit. Për më tepër, një aranzhim i përbashkët i cili nuk është i ristrukturuar nepërmjet një entiteti të ndarë ligjrisht është një operacion i përbashkët. Pra, Madeira sh.a duhet të njohë sa i përket këtij aranzhimi pasuritë detyrime të hyrat dhe shpenzimet që lidhen me përfshirjen e saj në këtë kontratë në pasyrat e saj të konsoliduara sipas kërkesave të SNRF-ve për njohjen e të hyrave.

b)

- SNK 21 *Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit valuator* qeveris trajtimin e transaksioneve në valutë të huaj. Fatura duhet të regjistrohet si shitje dhe e arkëtueshme me dhjetor 2019 çasti (spot) të këmbimit valuator në atë datë, pra €9,814,602 (100m/10.1889).
- Shuma e paguar në avans fillimisht regjistrohet si e hyrë e shtyrë prej €5,010,874 (50m/9.9783). Me 1 dhjetor 2019 një përfitim nga ndryshimi i kursit valutor prej €103,573 (€5,010,874 – €4,907,301 (50m/10.1889)) njihet në fitim ose humbje kur 50 milion lekë prej 100 milion lekëve të përkthyer të njohur si të arkëtueshme paguhen.
- Pjesa e mbetur prej 50 milion lekë të arkëtueshme përkthehet me 31 dhjetor 2019 me €4,760,227 (50m/10.5037) duke gjeneruar një humbje nga këmbimi valuator prej €147,074 (€4,907,301 (50m/10.1889) – €4,760,227).

- Dy kontrata përpara (forward) për kursin e këmbimit njihen sipas vlerës së drejtë prej €148,000 (si një pasuri pasi që leku ka rënë në vlerë) në pasqyrën e pozitës financiare.
- Duke qenë se janë mbrojtje të vlerës së drejtë ndryshimin në vlerën e drejtë prej €148,000 kreditohet tek fitimi ose humbja, duke eliminuar humbjen nga këmbimi valuator që është njohur në të arkëtueshmet.

c) Sipas modelit të kostos së amortizuar të SNRF 9 *Instrumentet financiare*, detyrimet financiare duhet të njihen fillimisht sipas vlerës së drejtë të parasë së pranuar. Çdo kosto që i atribuohet direkt emetimit të fletë-obligacionit duhet të zbritet nga vlera bartëse e detyrimit.

Andaj, në njohjen fillestare fletë-obligacioni duhet të matet në:

	€
Vlera e drejtë e konsideratës së pranuar	950,000
Minus: kosto e transaksionit	<u>(18,000)</u>
Vlera bartëse	932,000

Njohja dhe matja fillestare e detyrimit financiar është bërë në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare të Parana sh.a-së.

Hyrjet në ditar janë

D Paraja	950,0000	
K Detyrim financiar		932,000
K Tarifa e brokerit e pagueshme (kosto e transaksionit)		18,000

Megjithatë, metoda e kostos së amortizuar sipas SNRF kërkon që fletë-obligacioni të amortizohet përgjatë kohëzgjatjes duke përdorur normën efektive të interesit.

Rrjedhat e parasë të fletë-obligacionit janë

	€
Viti 0	932,000
Viti 1	(50,000)
Viti 2	(50,000)
Viti 3	(1,050,000)

Norma efektive e interesit e cila i skonton rrjedhat e ardhshme të parasë në vlerën e tanishme të fletë-obligacionit është 7.62% (rrumbullakësuar).

Plani i amortizimit të fletë-obligacionit duke përdorur normën efektive të interesit është si në vijim

Viti	Saldo në fillim	Pagesa e kuponit	Kosto financiare @ 7.62%	Diferenca: Kryegjëja	Saldo në fund
0	932,000				
1	932,000	(50,000)	71,018	21,018	953,018
2	953,018	(50,000)	72,620	22,620	975,638
3	975,638	(1,050,000)	74,344	24,344	999,982 (18)
					rrumbullakësim

3.

a) Rio Negro sh.a është një kompani e listuar në bursë. Me 1 janar 2019, kompania bleu 80% të aksioneve të zakonshme të Indus sh.a. Gjatë vitit, Rio Negro sh.a shiti për €5 milion mallra tek Indus sh.a me një fitim prej 20% në çmimin e shitjes. Me 1 janar 2019, Rio Negro sh.a bleu 35% të aksioneve të zakonshme të Brahmaputra sh.a për €6.8 milion dhe ishte në gjendje të ushtroj influencë domëthënëse sh.a pas blerjes. Gjatë vitit, Brahmaputra sh.a shiti mallra për €2.1 milion tek Rio Negro sh.a me një kosto plus fitimi prej 10%. Në tetor 2019, Rio Negro sh.a mori një kredi prej €30 milion nga Banka Yamuna sh.a për kapital qarkullues.

Kërkohet:

- i) **Diskuto nëse Indus sh.a, Brahmaputra sh.a dhe Banka Yamuna sh.a janë palë të lidhura me Rio Negro sh.a sipas SNK 24 *Shpjegimet e palëve të lidhura*. (4 pikë)**
- ii) **Bazuar në përgjigjen tuaj në (i), trego cilat transaksione duhet të shpalosen në shënimet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 sa i përket palëve të lidhura. (2 pikë)**

b) Rastet në vijim janë të pavarura nga njëra tjetra. Draft pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 nuk kanë përfshirë transaksionet në vijim:

- i) Mekong sh.a ishte caktuar si agjent dhe shitjet si agjent ishin €350,000 gjatë vitit. Mekong sh.a fitoi një provision prej 20% të shitjeve.
- ii) Japura sh.a realizoi shitje prej €500,000 me 24 dhjetor 2019. Shuma është faturuar dhe është arkëtuar nga blerësi por, blerësi ka kërkuar që malli të mbetet në depot e Japura sh.a dhe t'i dërgohet me 10 janar 2020. Japura sh.a ka transferuar rreziqet dhe shpërblimet signifikante të pronësisë së mallrave tek blerësi.
- iii) Jurua sh.a ka një kontratë €200,000 për të furnizur me mallra një qendër studimi dhe €50,000 janë pranuar si depozit me 30 dhjetor 2019. Mallrat pritet të dërgohen në shkurt 2020 dhe pjesa e mbetur prej €150,000 do të arkëtohet në atë kohë.

Kërkohet:

Trego shumën e të hyrave që duhet të njihen për secilin transaksion për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019. Arsyet duhet të jipen për secilin rast. (6 pikë)

c) SNRF-të kërkojnë që përfitimet ose humbjet nga rimatja të trajtohen në pasqyra për secilin zë të pasurive në vijim:

- (i) Patundshmëritë, impiantet e prodhimit & paisjet të mbajtura sipas modelit të rivlerësimit të SNK 16 *Patundshmëritë, impiantet e prodhimit & paisjet*. (4 pikë)
- (ii) Investimet në pasuri të patundshme të mbajtura sipas modelit të vlerës së drejtë të SNK 40 *Investimet në pasuri të patundshme*. (2 pikë)
- (iii) Pasuritë financiare me vlerën e drejtë sipas SNRF 9 *Instrumentet financiare*. (4 pikë)

Kërkohet:

Shpjego se si duhet të trajtohet rimatja e zërave mësipër dhe ku duhet të njihen përfitimet ose humbjet në pasqyrën e fitimit ose humbjes apo të të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.

Zgjidhja e problemit 3

a)

i)

- Indus sh.a. Palë e lidhur sepse Indus sh.a është filial i Rio Negro sh.a
- Brahmaputra sh.a. Palë e lidhur sepse Brahmaputra sh.a është një ortakëri e Rio Negro sh.a
- Yamuna Bank sh.a. Nuk është palë e lidhur sepse Banka Yamuna Bank është vetëm financues në aktivitetin e saj të zakonshëm.

ii) Transaksionet

Indus sh.a

Shitjet e Rio Negro tek Indus sh.a prej €5 milion me një fitim prej €1 milion.

Brahmaputra sh.a.

Shitjet e Brahmaputra tek Rio Negro prej €2.1 milion me një fitim prej €190,000

b)

Shuma e të hyrave që duhet të njihet gjatë vitit

i) $20\% \times €350,000 = €70,000$

Agjenti duhet të njohë të hyrë vetëm komisionet e shitjeve gjatë vitit.

ii) €500,000

Të hyrat mund të njihen gjatë vitit pasi që vonesa për dërgim është bërë nga vet blerësi.

iii) Zero. Të hyrat do të njihen në datën e dërgesë së mallrave.

c) Rritjet në vlerë në rastet kur kemi të bëjmë me një rivlerësim

Debia do të jetë një rritje në vlerën e pasurisë në pasqyrën e pozitës financiare. SNK 16 kërkon që rritja të kreditohet ndaj një rezerve të rivlerësimit (pra pjesë e ekuitetit të pronarëve) dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, me përjashtim të rasteve kur rritja është stornimi i një zvogëlimi të mëparshëm i cili ishte njohur si shpenzim. Në rastet kur bëhet ky stornim, rritja njihet si fitim në pasqyrën e fitimit ose humbjes; ajo që tepron i shkon rezervës së rivlerësimit.

Të gjitha zvogëlimet duhet të njihen si shpenzime, me përjashtim të rasteve kur këto stornojnë një rritje të mëparshme e cila është regjistruar si rezervë e rivlerësimit në ekuitetin e pronarëve. Të gjitha zvogëlimet të cilat janë më të mëdha se sa rritja e mëparshme në vlerë duhet të trajtohen si humbje në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(ii) Entiteti i cili zgjedh përdorimin e modelit të vlerës së drejtë duhet të masë të gjitha investimet e veta në pasuri të patundshme me anë të vlerës së tyre të drejtë, me përjashtim të rasteve jashtëzakonisht të rralla kur vlera në fjalë nuk mund të matet me besueshmëri. Në raste të tilla duhet të zbatohet modeli i kostos i përshkruar në SNK 16.

Fitimet ose humbjet që dalin në pah nga ndryshimi i vlerës së drejtë të një investimi në pasuri të patundshme duhet të njihen në fitimin ose humbjen neto të periudhës në të cilën ato dalin në pah.

- (iii) Sipas SNRF 9 *Instrumentet financiare* pasuritë mund të mbahen në kategorinë e “vlerës së drejtë” ose “kostos së amortizuar”. Kategorizimi nuk është opcional, por varet nga lloji i instrumentit dhe modeli i biznesit të entitetit për mbajtjen e asaj pasurie. Metoda e “vlerës së drejtë” aplloket për të gjitha instrumentete financiare për të cilat nuk aplikohet metoda e “kostos së amortizuar”.

Çfardo ndryshimi në vlerën e drejtë normalisht njihet në fitim dhe humbje.

Ka dy përjashtime të kësaj rregulle:

- Pasuria është pjesë e një marrëdhënie të mbrojtjes (shih Seksionin 6)
- Pasuria financiare është një investim në instrument të ekuitetit që nuk mbahet për tregtim. Në këtë rast entiteti mund të bejë një zgjedhje të përvokueshme që të njoh ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse

4. Orinoco sh.a kryen aktivitet të rritjes së peshkut në fermë. Shet krap për klientë të ndryshëm nepërmjet pikave të shitjes me pakicë. Kompania është krijuar 6 vite më parë. Në vijim janë pasqyrat financiare të Orinoco sh.a për vitet e perfunduar me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor:

	2019	2018
	€'000	€'000
Të hyrat	6,400.00	6,000.00
Kosto e shitjeve	<u>(2,520.00)</u>	<u>(1,800.00)</u>
Fitimi bruto	3,880.00	4,200.00
Të hyrat tjera	120.00	150.00
Kosto e shpërndarjes	(1,175.00)	(1,050.00)
Kosto administrative	(2,100.00)	(1,800.00)
Kosto financiare	<u>(375.00)</u>	<u>(195.00)</u>
Fitimi para tatimit	350.00	1,305.00
Tatimi	<u>(70.00)</u>	<u>(261.00)</u>
Fitimi për periudhën	280.00	1,044.00
<i>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</i>		
Përfitimi/ (humbja) nga rivlerësimi	(65.00)	75.00
Neto përfitimi nga vlerësimi i ekspertëve	<u>105.00</u>	<u>-</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse	320.00	1,119.00

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor:

	2019	2018
	€'000	€'000
Pasuritë		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Pasuri të patundshme, impiantet e prodhimit dhe paisjet	4,214.90	2,790.40
Investimet në pasuri të patundshme	1,374.00	990.00
Pasuritë tjera të trupëzuara	756.00	630.00
Tatimi i shtyrë	<u>141.00</u>	<u>-</u>
	6,485.90	4,410.40
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	330.00	300.00
Të arkëtueshmet tregtare	450.00	468.00
Paraja & ekuivalentët e parasë	<u>192.00</u>	<u>69.00</u>
	<u>972.00</u>	<u>837.00</u>
Total pasuritë	7,457.90	5,247.40
Ekuiteti dhe detyrimet		
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e ekuitetit prej €0.50 secila	960.00	630.00
Komponentë të tjerë të ekuitetit	702.50	65.00
Fitimet e mbajtura	<u>1,230.40</u>	<u>1,020.40</u>
Total ekuiteti	2,892.90	1,715.40

Detyrimet

Detyrimet afatgjata

Përfitimet e punonjësve	780.00	924.00
Tatimi i shtyrë	-	390.00
20% Notë krediti	<u>3,000.00</u>	<u>1,560.00</u>
	3,780.00	2,874.00

Detyrimet afatshkurtëra

Të pagueshmet tregtare	390.00	402.00
Tatimi	20.00	61.00
Kosto financiare e pagueshme	<u>375.00</u>	<u>195.00</u>
	<u>785.00</u>	<u>658.00</u>
Total detyrimet	<u>4,565.00</u>	<u>3,532.00</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	7,457.90	5,247.40

Informata shtesë:

- i) Orinoco sh.a rriti çmimin e peshkut per kg në €200 nga €120 për shitjet brenda vendit dhe në US\$20 nga US\$12 për eksportet efektive nga 1 janar 2019. Gjithashtu, pjesëmarrja e eksporteve në vlerën e shitjeve totale u rrit nga 30% në 40%.
- ii) Të hyrat tjera kanë të bëjnë me fitimin nga shitja e pasurive jo-qarkulluese. Kompania ka një politikë të shitjes së pasurive jo-qarkulluese pas pesë viteve të përdorimit.
- iii) Në periudhën kontabël 2019, Orinoco sh.a rriti numrin e fermave në 30 nga 16.
- iv) Orinoco sh.a i rriti pagat punonjësve për 10% nga 1 gushti 2019.
- v) Orinoco sh.a importon 70% të peshkut të saj. Norma mesatare e kursit të këmbimit në vitin 2019 ishte €10.9 për 1 USD krahasuar me €11.5 për 1 USD në vitin 2018.
- vi) Orinoco sh.a ndryshoi politiken e kontabilitetit për investimet në pasuri të patundshme nga modeli i kostos në modelin e vlerës së drejtë nga 1 janar 2019. Ndryshimi në politikën e kontabilitetit është trajtuar drejtë në të dy periudhat e kontabilitetit.
- vii) Orinoco sh.a pagoi dividenda në total prej €175,000 në vitin deri me 31 dhjetor 2019 dhe €105,000 në vitin deri me 31 dhjetor 2018.
- viii) Orinoco sh.a ka emetuar aksionet shtesw tw ekuitetit me 1 janar 2019.

Kërkohet:

Shkruaj një raport për bordin e drejtorëve lidhur me vlerësimin e performancës dhe pozitës financiare të Orinoco sh.a për vitin e përfunduar deri me 31 dhjetor 2019. (20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

Për: Bordin e drejtorëve - Orinoco sh.a

Nga: Kontabilisti i Çertifikuar

Data: 22 gusht 2020

Tema: Vlerësimi i performancës dhe pozitës financiare të Orinoco sh.a

Hyrje

Vlerësimi i performancës dhe pozitës financiare të Orinoco sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 është bazuar në informatat financiare për të dy vitet. Është përdorur analiza e koeficientëve si dhe informatat shtesë të dhëna.

Vlerësimi i performancës dhe pozitës financiare

Profitabiliteti

Të hyrat janë rritur për 7% (L1) edhe pse Euro është forcuar në €10.9/US\$ nga €11.5/US\$. Kjo ishte kryesisht për shkak të rritjes së çmimit të shitjes për kg nga €120 në €200 për shitjet vendore dhe në US\$20 nga US\$12 për eksportet. Përveç kësaj, analiza e të hyrave zbuloi një rënie në shitjet në kg nga 48.04 në 30.94 (L1). Rënia në vëllimin e shitjeve të peshkut në vitin 2019 tregon efektin e rritjes së çmimit të shitjes.

Marzha e fitimit bruto është zvogëluar nga 70% në 61% (L1). Ngjajshëm, marzha e fitimit operativ është zvogëluar nga 25% në 11% (L1). Zvogëlimi në këto marzha është kryesisht për shkak të rritjes së kostove prej 30% të peshkut të blerë në vend dhe kjo i ka anuluar kursimet e peshkut të blerë për shkak të forcimit të euros, nga €11.5/US\$ në €10.9/US\$. Për më tepër, kostot që kanë të bëjnë me punonjësit janë rritur për 10% për shkak të rritjes së pagave. Rillogaritja e fitimit operativ neto, duke injoruar përfitimet nga shitja e pasurive jo-qarkulluese prej, €120,000 në vitin 2019 dhe €150,000 në vitin 2018 dhe përfitimin nga rritja në vlerën e drejtë të investimit prej €384,000 (€1,374,000 - €990,000), do të japë €221,000 në vitin 2019 dhe €1,350,000 në vitin 2018. Kjo do të ndryshonte marzhën e fitimit operativ nga 3% dhe 23% në vitin 2019 dhe 2018 respektivisht. Megjithatë, duket se kompania e konsideron rënien në profitabilitet të përkohshëm duke u bazuar në vendimin për të rritur në mënyrë të konsiderueshme numrin e fermave nga 16 në 30 dhe rritjen e pagave të punonjësve.

Kthimi në kapitalin e angazhuar tregon një trend të ngjajshëm të përkeqësimit. Ka rënë në mënyrë drastike nga 33% në 11% (L1). Kjo është për shkak të ndryshimit në politikën e kontabilitetit të investimit në pasuri të patundshme nga modeli i kostos në modelin e vlerës së drejtë, rritjes së numrit të fermave nga 16 në 30 dhe rënies së profitabilitetit të kompanisë.

Likuiditeti dhe kapitali qarkullues

Koeficienti qarkullues ka rënë pak nga 1.27 në 1.24 (L12). Koeficienti i shpejtë në anën tjetër ka mbetur i njëjtë në 0.82 (L12). Të dy koeficientët tregojnë se pasuritë qarkulluese të Orinoco sh.a's janë të mjaftueshme për ti përmbushur detyrimet afatshkurtëra. Kjo tregohet edhe me rënien e periudhës së arkëtimit të arkëtueshmeve tregtare nga 28 ditë në 26 ditë (L12). Në anën tjetër periudha e pagesës së të pagueshmeve tregtare të Orinoco sh.a ka rënë nga 82 ditë në 56 ditë (L12).

Qarkullimi i stoqeve është shpejtuar nga 61 ditë në 48 ditë (L12). Megjithatë, ky nuk është tregues i rritjes së aktivitetit biznesor. Kjo është për shkak se vëllimi i shitjeve ka rënë nga

48.04 në 30.94 (L11). Shifra e stoqeve është rritur nga €300,000 në €330,000. Ky zvogëlim në qarkullimin e stoqeve ishte kruesisht për shkak të rritjes së kostos së shitjeve.

Koeficientët e borxhit dhe levës financiare

Nivelet e leves ne terma relativ janë rritur nga 48% në 51%(L13) siq mund të shihet nga koeficientët e hyrjes ne borxh nga 91% në 104%(L13). Megjithatë në terma aboslut borxhi është rritur nga €1,560,000 në €3,000,000 që paraqet rritje prej 92%. Kjo ka pasur efekt në zvogëlimin e mbulimit të interesit nga 7.69 here në 1.93 here (L13). Kjo është edhe për shkak të rënies së profitabilitetit të kompanisë.

Kompania do ta ketë të veshtirë të mbajë nivelet aktuale të borxhit dhe të marrë financim shtesë për operacionet e saj nëse nuk përmirësohet profitabiliteti.

Koeficientët e investimeve të aksionarve

Fitimi për aksion i Orinoco sh.a's ka rënë nga €0.83 në €0.15 (L14). Kjo është shkaktuar nga zvogëlimi i profitabilitetit të kompanisë dhe rritjes së numrit të aksioneve të ekuitetit. Megjithatë, dividendat për aksion është rritur €0.08 në €0.09 (L14) e cila mund të mos jetë e qëndrueshme nëse nuk përmirësohet profitabiliteti i kompanisë.

Konkluzion

Orinoco sh.a ka performancë dhe pozitë financiare të përzier. Profitabiliteti i kompanisë ka rënë përderisa disa koeficientë të likuiditetit kanë mbetur pothuajse të njëjtë. Megjithatë ka pak përmirësim në menaxhimin e kapitalit qarkullues. Kompania ka nevojë të përmirësoj profitabilitetin e saj dhe të menaxhoj borxhin në nivele të qëndrueshme. Kompania mund gjithashtu të marrë në konsideratë zvogëlimin e çmimit të shitjes për të rikthyer disa prej klientëve të humbur. Mbetet shumë e rëndësishme të shikohen edhe koeficientët në industri për të pasur një pasqyrë më të qartë të performancës dhe pozitës financiare të Orinoco sh.a.

Llogaritjet

L11

Koeficientët e profitabilitetit

Rritja në përqindje e të hyrave = Rritja e të hyrave/ Të hyrat në vitin e kaluar=
 $(6,400 - 6,000) / 6,000 = 400.00 / 6,000.00 = 7\%$

	2019	2018
Analiza e të hyrave		
Eksportet (Euro)	2,560.00	1,800.00
Shitjet vendore (Euro)	3,840.00	4,200.00
Çmimi mesatar i shitjes per kg		
Eksportet (\$20* 10.9)/(\$12*11.5)	218.00	138.00
Shitjet vendore	200.00	120.00
Shitjet në kg		
Eksportet (2,560/218)/(1,800/138)	11.74	13.04
Shitjet vendore (3,840/200)/(4,200/120)	<u>19.20</u>	<u>35.00</u>
	30.94	48.04

Kthimi në kapitalin e angazhuar = FPIT/ KA =

= $(350+375) / (7,457.9-785)$; $(1,305+195) / (5,247.40 -658)$ 11% 33%

Marzha e fitimit operativ = FPIT / të hyrat = (350+375)/6,400; (1,305+195)/ 6,000	11%	25%
Marzha e fitimit bruto = 3,880/6,400; 4,200/6,000.00	61%	70%
Qarkullimi i pasurive = Të hyrat / Kapitali i angazhuar 6400/6,672.90; 6,000/4,589.40	0.96	1.31
Total shpenzimet si përqindje e shitjeve= Shpenzimet/shitjet 3,650.00/6,400.00; 3,045.00/6,000.00	57%	51%

L12

Koeficientët e likuiditeti dhe kapitali qarkullues

Koeficienti qarkullues = Pasuritë qarkulluese/detyrimet afatshkurtëra

972.00/785.00; 837.00/658.00 1.24 1.27

Koeficienti i shpejtë = (Pasuritë qarkulluese – stoqet)/detyrimet afatshkurtëra
642.00/785.00; 537.00/658.00 0.82 0.82

Periudha e qarkullimit të stoqeve = Stoqet/Kosto e shitjeve x 365 ditë
330/ 2,520.00 x 365; 300/1,800.00 x 365 48 61

Periudha e arkëtimit = Të arkëtueshmet tregtare/të hyrat x 365 ditë
450/ 6,400.00 x 365; 468 / 6,000.00 x 365 26 28

Periudha e pageses së të pagueshmeve tregtare = Të pagueshmet tregtare/ Kosto e shitjeve x 365 ditë
390/ 2,520.00 x 365; 402/1,800.00 x 365 56 82

L13

Koeficientët e borxhit dhe levës financiare

Hyrja në borxh = (Borxhi nga interesi /Borxhi nga interesi + ekuiteti) x 100%

3,000.00/5,892.90 x 100%; 1,560.00/3,275.40 x 100% 51% 48%

Ose Borxhi nga interesi / Ekuiteti x 100%

3,000.00/2 892.90 x 100%; 1,560.00/1,715.40 x 100% 104% 91%

Mbulimi i interesit = FPIT/Interesi i pagueshëm
725.00 / 375.00; 1,500.00/195.00 1.93 7.69

L14

Koeficientët e investimeve të aksionarve

Fitimi për aksion =

=Fitimi i atribuar aksionarve të zakonshëm/numri mesatar i ponderuar i aksioneve
280.00/1,920.00; 1,044.00/1,260.00 0.15 0.83

Mbulimi i dividendës = Fitimi i atribuar aksionarve të zakonshëm/ dividenda e paguar
280.00/175.00; 1,044.00/105.00 1.60 9.94

Dividenda për aksion = dividenda e paguar/ numri i aksioneve
175.00/1,920.00; 105.00/1,260.00 0.09 0.08

5. Sepik sh.a është një kompani shumë e diversifikuar me divizione të cilat mbulojnë një varg të aktiviteteve të ndryshme. Një analizë e divizioneve është e paraqitur në tabelën më poshtë.

	Shitja me pakicë	Teknologjia informative	Transporti detar	Afarizmi bankar	Të tjera	Total
	€m	€m	€m	€m	€m	€m
Të hyrat e jashtme	210	270	55	50	45	630
Të hyrat nga segmentet tjera	40	5	0	8	2	55
Total të hyrat	250	275	55	58	47	685
Fitimi i raportuar	55	45	10	9	11	130
Total pasuritë	5,000	4,000	250	450	610	10,410

Kërkohet:

- i) Shpjego çfarë është një 'segment operativ' dhe kur duhet të raportohet për të në pajtim me SNRF 8 *Segmentet operative*. (5 pikë)
- ii) Shpjego se cilat nga divizionet e Sepik sh.a janë segmente të raportueshme sipas SNRF 8 *Segmentet operative*. (5 pikë)

Drejtorët janë të informuar lidhur me çështjen e një standardi të ri SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me klientët*. "Modeli pesë hapësh" i propozuar për këtë standard është duke u diskutuar. Drejtorët e Sepik sh.a kërkojnë sqarim për këtë model për njohjen e të hyrave.

Kërkohet:

- iii) Spjego qasjen e propozuar për modelin prej pesë hapave për njohjen e të hyrave në standardin të ri të njohjes së të hyrave. (10 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

5.

i) Një segment operativ perkufizohet si ne vijim:

- një komponent [përbërës] i një entiteti i cili merret me aktivitete biznesi nga të cilat mund të gjenerohen të hyra dhe të ndodhin shpenzime (përfshirë të hyrat dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me transaksionet me komponentë [përbërës] të tjerë të të njëjtit entitet
- rezultatet operative të të cilit rishikohen rregullisht nga vendim – marrësit kryesorë operativë [ekzekutivë] të entitetit të cilët marrin vendime për sa i takon burimeve që do të duhet të shpërndahen ndaj segmentit dhe vlerësojnë performancën e tij, dhe
- Për të cilin janë në dispozicion informacione financiare të veçanta.

Entiteti duhet të raportojë veçmas informacionet që kanë të bëjnë me të gjitha segmentet operative të cilat:

- (i) të hyrat (edhe brenda kompanise edhe me palët e jashtme) janë 10% ose më shumë të totalit të kompanisë (të jashtme dhe te brendshme); ose
- (ii) fitimi ose humbja është 10% ose më shumë e më të lartës prej:
 - fitimit të përbashkët të të gjitha segmenteve që nuk kanë raportuar humbje; dhe
 - humbjes se përbashkët të të gjitha segmenteve; ose
- (iii) pasuritë janë 10% ose më shumë të pasurive të përbashkëta të të gjitha segmenteve.

Të paktën 75 % e totalit të të hyrave të jashtme duhet të raportohen sipas segmenteve operative. Në rastet kur një gjë e tillë nuk është e mundur, duhet të identifikohen segmente shtesë (madje edhe në qoftë se nuk e arrijnë pragun prej 10 %).

ii) Duke pasur parasysh kriteret edhe divizioni i shitjeve me pakicë edhe ai i teknologjisë informative përmbushin kriterin e >10% të të hyrave totale. Asnje prej divizioneve të tjera nuk përmbush ndonjërin prej tri kriterëve.

Megjithatë, të hyrat totale të jashtme të divizionit të shitjeve me pakicë dhe të teknologjisë informative përbëjnë vetëm 74% (480/650) të totalit të të hyrave të jashtme të kompanisë. Andaj, ne duhet të përfshijmë edhe divizionin e transportit detar në analizen e segmenteve (divizioni tjetër me i madh) për të përmbushur kriterin prej 75% të kërkuar nga SNRF 8 *Segmentet operative*.

iii)

Qasja e propozuar

Hapi 1 *Identifiko kontratat me konsumatorët.*

Identifikimi i një kontrate është zakonisht shume e thjeshtë, pasi që do të ketë një marrëveshje të shkruar apo ndonjë alternative tjetër sipas praktikave të biznesit. Entiteti zakonisht do të trajtonte kontratën ndarazi, por ka raste kur mind të i kombinojnë ato. Pika kuqe është ndërvarësia çmimore. Zakonisht një kompani do të aplikonte propozimet për një kontratë. Megjithatë, në disa raste kompania do të merrte parasysh dy apo më shumë kontrata së bashku nëse çmimet e atyre kontratave jane në ndërvarësi. Në të kundërtën, një kompani do

të ndante një kontratë të vetme dhe do ta merrte parasysh si dy apo më shumë kontrata nëse disa mallra apo shërbime janë çmimuar pavarësisht nga mallrat dhe shërbimet tjera.

Hapi 2 *Identifiko obligimet e ndara të përformancës.*

Pika kyqe është mallrat apo shërbimet e dallueshme, Një kontratë përfshinë permtimin për të siguruar mallra apo shërbime ndaj një klienti. Ato premtime quhen obligime të përformancës. Një kompani do të mbante llogari për obligimin e përformancës ndarazi vetëm nëse mallrat apo shërbimet e premtuara dallohen. Një mall apo shërbim është I dallueshëm nëse shitet ndarazi apo mund të shitet veçmas sepse ka një funksion të dallueshëm dhe marzhë të fitimit të dallueshme.

Hapi 3 *Përcakto çmimin e transaksionit.*

Propozimi kyq është shuma e pritur e pëshuar sipas probabilitetit. Çmimi i transaksionit do të reflektonte vlerësimet e bazuara në probabilitet të kompanisë të konsideratave të ndryshme (përfshirë vlerësime të arsyeshme të shumave kontigjente) përveq efekteve te rrezikut kreditor të klientit dhe vlerën në kohë të parasë (nëse është materiale).

Hapi 4 *Aloko çmimin e transaksionit për onligimet e përformancës.*

Propozimi kyq është alokimi relative i çmimit shitës. Një kompani do të alokonte çmimin e transaksionit tek të gjitha obligimet e ndara të përformacës në proporcion me çmimin e shitjes të vetëm mallit apo shërbimit që i përket obligimi i përformancës. Nëse malli apo shërbimi nuk shitet ndarazi, kompania do të vlerësonte çmimin shitës ndarazi të tij.

Hapi 5 *Njih të hyrat kur obligimi ndaj përformancës është përmbushur.*

Një kompani do të njihje të hyrat kur të përmbush një obligim të përformancës duke transferuar mallin apo shërbimin e premtuar tek klienti. Malli apo shërbimi është transferuar kur konsumatori merr kontrollin e mallit apo shërbimit të premtuar. Një tregues i kësaj është kur konsumatori ka rrezikun dhe shpërblimet e pronësisë.

Shuma e të hyrave e njohur është shuma e alokuar tek ai obligim i përformancës në Hapin 4